

## AKT THEMELIMI

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “MILLENNIALS” SH.P.K

Sot më datë 12.04.2021

Z. Muhamet Zeneli, shtetas Shqiptar, lindur më 27 Shtator 1992, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J20927062B, dhe

Z. Flavio Zeneli, shtetas Shqiptar, lindur më 30 Prill 1996, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J60430065G.

kanë hartuar si më poshtë vijon Akt Themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar të cilën kanë vendosur ta quajnë “MILLENNIALS” SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ortaket kanë vendosur krijimin e shoqërisë për të zhvilluar aktivitet privat me objekt të veprimtarisë:

*“Aktivitet në fushën e ndërtimit si punë karpentieri, hekurthyes, murature, suvatime, nivelime, shtrime pllakash e parketesh, punime elektrike, hidraulike, alumini, dyer dhe dritare, gipsi, lyerje etj. Tregtim me pakice e shumicë të materialeve të ndërtimit. Ndërtime të objekte të ndryshme. Riparime e restaurime në fushën e ndërtimit. Krijimin, zhvillimin, implementimin, tregtimin dhe ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes të sistemeve elektronike dhe të teknologjisë së informacionit në çdo fushë të ekonomisë, prodhuar prej shoqërisë ose personave të tretë.”*

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100,000 (njëqind mijë) Lekë,

Z. Muhamet Zeneli, shtetas Shqiptar, lindur më 27 Shtator 1992, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J20927062B, zotërues i 1 (një) kuote sa (50% te kapitalit) të barabartë me vlerë nominale 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë.

Z. Flavio Zeneli, shtetas Shqiptar, lindur më 30 Prill 1996, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J60430065G, zotërues i 1 (një) kuote sa (50% te kapitalit) të barabartë me vlerë nominale 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë.

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar.

Selia qendrore e shoqërisë do të jetë në adresën: Rrugën “E Qelqit”, PLL. “Derveni”, K.2, SH.2, NJ.SH. 34, Z.K. 3866, Nr. Pasurie 342/59-N41, Yzberish, Tiranë.

Administrator i shoqërisë do të jetë:



Z. Flavio Zeneli, shtetas Shqiptar, lindur më 30 Prill 1996, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J60430065G

Përfaqësimi ndaj të tretëve do të bëhet nga Administratori i Shoqërisë.


Konfliktet që mund të lindin nëse nuk arrihet të zgjidhen me konsensus do të zgjidhen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë dhe mbaron më 31.12.2021. Çdo vit tjetër financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Ky akt themelimi përbëhet nga dy faqe, është hartuar më 17.03.2021 në tre njësi (kopje) origjinale duke patur fuqi të barabartë ligjore.


### ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

#### “MILLENNIALS” SH.P.K

Z. Muhamet Zeneli

Muhamet Zeneli  


Z. Flavio Zeneli

Flavio Zeneli  


**STATUT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“MILLENNIALS” SH.P.K**

**THEMELIMI**

**Neni 1  
Themelimi i Shoqërisë**

1.1 Shoqëria MILLENNIALS (“Shoqëria”) është themeluar nga:

**Z. Muhamet Zeneli, shtetas Shqiptar, lindur më 27 Shtator 1992, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J20927062B, dhe**

**Z. Flavio Zeneli, shtetas Shqiptar, lindur më 30 Prill 1996, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J60430065G.**

këtu e më poshtë “Ortakët”

**Neni 2  
Emri**

2.1 Emri i Shoqërisë do të jetë “MILLENNIALS” SH.P.K.

**Neni 3  
Forma Ligjore**

3.1 Ortakët kanë krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3.2 Shoqëria mund të transferohet në ndonjë formë tjetër në përputhje me legjislacionin në Shqipëri.

**Neni 4  
Baza Ligjore**

4.1 Shoqëria do ta kryejë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera të ligjit Shqiptar.



**Neni 5**  
**Kohëzgjatja**

- 5.1 Shoqëria do të fillojë aktivitetin e saj pas regjistrimit pranë regjistrimit tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- 5.2 Shoqëria është krijuar për një afat të pacaktuar.

**Neni 6**  
**Selia /Zyra e regjistruar**

- 6.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në Rrugën "E Qelqit", PLL. "Derveni", K.2, SH.2, NJ.SH. 34, Z.K. 3866, Nr. Pasurie 342/59-N41, Yzberish, Tiranë.
- 6.3 Shoqëria mund të themelojë degë, filiale dhe zyra përfaqësimi në territorin e Shqipërisë ose në vende të tjera.
- 6.4 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera në Shqipëri, ekzistuese ose që mund të krijohen në Republikën e Shqipërisë dhe në vende të tjera.

**Neni 7**  
**Objekti**

- 7.1 Objekti i Shoqërisë do të konsistojë në *"Aktivitet në fushën e ndërtimit si punë karpentieri, hekurkthyes, murature, suvatime, nivelime, shtrime pllakash e parketesh, punime elektrike, hidraulike, alumini, dyer dhe dritare, gipsi, lyerje etj. Tregtim me pakice e shumicë të materialeve të ndërtimit. Ndërtime të objekte të ndryshme. Riparime e restaurime në fushën e ndërtimit. Krijimin, zhvillimin, implementimin, tregtimin dhe ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes të sistemeve elektronike dhe të teknologjisë së informacionit në çdo fushë të ekonomisë, prodhuar prej shoqërisë ose personave të tretë."*
- 7.2 Objekti i Shoqërisë mund të modifikohet ose ndryshohet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 8**  
**Kapitali**

- 8.1 Kapitali fillestar i Shoqërisë është **100,000 (njëqind mijë) Lekë**. Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 2 pjesë me vlerë nominale prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë.
- 8.1 Kapitali zotërohet nga Ortakët si më poshtë:
- |                        |             |
|------------------------|-------------|
| <b>Muhamet Zeneli:</b> | <b>50 %</b> |
| <b>Flavio Zeneli:</b>  | <b>50 %</b> |



## Neni 9

### Transferimi i pjesë të kapitalit. Kufizimet mbi transferimin.

- 9.1 Ortakët janë zotëruesit ekskluzive të të gjithë kuotave të kapitalit të regjistruar.
- 9.2 Kuotat e kapitalit të regjistruar mund të transferohen, të gjitha ose pjesërisht, tek një person i tretë vetëm nëpërmjet një kontrate me shkrim.
- 9.3 Kuotat e kapitalit të regjistruar i transferohen nëpërmjet trashëgimisë pa ndonjë akt të veçantë. Gjithsesi, për të fituar statusin e ortakut trashëgimtar, trashëgimtarët duhet të dorëzojnë dokumentet e trashëgimisë në Librin e Trashëgimtarëve.

## Neni 10

### Rritja e Kapitalit

- 10.1 Ortakët mund të zmadhojnë kontributet e tyre në kapitalin e regjistruar.
- 10.2 Kapitali mund të zmadhohet edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së kuotave të reja nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj duhet të pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

## Neni 11

### Zvogëlimi i Kapitalit

- 11.1 Bazuar ne vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, zvogëlimi i kapitalit mund të kryhet në përputhje me të gjitha procedurat e parashikuara nga ligji tregtar.

## STRUKTURA QEVERISESE

## Neni 12

### Asambleja e Përgjithshme

- 12.1 Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë merren nga Asambleja e Përgjithshme e cila është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë dhe ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.
- 12.2 Vetëm Asambleja e Përgjithshme e ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
  - (a) Ndryshime dhe modifikime të Statutit
  - (b) Pranimi i ortakëve të rinj (pas zmadhimit të kapitalit ose transferimit të kuotave);
  - (c) Zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
  - (d) Vendos mbi bashkimin, likuidimin, shkrirjen ose çdo lloj shndërrimi të Shoqërisë;



- (e) Të vendos në blerjen dhe/ose përfitim të interesit pjesëmarrjes në Shqipëri ose jashtë saj;
- (f) Hapja dhe/ose mbyllja e degëve dhe përfaqësimeve;
- (g) Miratimin e bilancit dhe raporteve vjetorë dhe miratimi i shpërndarjes së fitimit;
- (h) Miratimi i rregullave të brendshme të administrimit;
- (i) Ngritja e padive kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
- (j) Blerja, shitja ose vënia në hipotekë e pasurive të paluajtshme;
- (k) Vendos mbi likuidimin e Shoqërisë;
- (l) Caktimin dhe shpërblimin e Administratorëve;
- (m) Caktimin e ekspertëve kontabël të miratuar;
- (n) Të përcaktoje organizimin strukturor dhe administrativ të Shoqërisë;
- (o) Miratimi i buxhetit vjetor;
- (p) Miratimin e çdo çështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me ligjin dhe/ose këtë Statut;

### Neni 13 Administrimi i Shoqërisë

- 13.1 Shoqëria do të administrohet nga një ose më shumë administratorë.
- 13.2 Administratorët kanë të drejtë të përfaqësojnë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për arritur dhe përmbushur qëllimin e Shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që me ligj i përkasin Asamblesë së Përgjithshme.
- 13.3 Administratorët, duke vepruar bashkërisht, mund të lëshojnë prokura për një ose më shumë individë ("Përfaqësues") për të përfaqësuar Shoqërinë.
- 13.4 Në qoftë se janë emëruar dy ose më shumë Administratorë, ata do ta përfaqësojnë Shoqërinë bashkërisht me përjashtim të rasteve kur bazuar me vendimeve të herë pas herë të Asamblesë së Përgjithshme, administratorëve do ju jepet e drejta për ta përfaqësuar Shoqërinë në grup prej dy dhe/ose individualisht për disa kategori veprimesh por vetëm në përputhje me kufizimet për këto veprime. Këto vendime do të jenë detyruese për administratorët dhe do të depozitohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit që tu bëhen të ditur palëve të treta.
- 13.5 Administratorët organizojnë dhe administrojnë të gjithë veprimtarinë tregtare të Shoqërisë. Ata janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në çdo çështje që lidhet direkt ose indirekt me të.





13.6 Të drejtat dhe detyrimet e Administratorëve janë ato të përcaktuara në Ligj, këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.

14.6 Administratorët kanë të drejtat e mëposhtme:

- (a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe organeve publike;
- (b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
- (c) marrja e huave në emër të Shoqërisë dhe miratimi i kushteve të huas;
- (d) përfundimin e marrëveshjeve për marrjen e huave;
- (e) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrja e porosive;
- (f) nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- (g) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënies;
- (h) dhënien e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga pagitë që vijnë si pasojë e marrëdhënies të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre heqjeve dorë;
- (i) punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- (j) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj;
- (k) ndërmarrjen e të gjithë veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- (l) kontrolli i shpenzimeve të Shoqërisë
- (m) mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
- (n) përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose nga një vendim i Asamblesë së Përgjithshme;
- (o) thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme për shpalljen e vendimeve përkatëse.
- (p) Publikimi i njoftimeve të nevojshme duke përfshirë edhe publikimi i pasqyrave financiare vjetore.

Administratori i Shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare do të jetë:



**Z. Flavio Zeneli, shtetas Shqiptar, lindur më 30 Prill 1996, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J60430065G**

**Neni 14**  
**Eksperti Kontabël i miratuar**

14.1 Eksperti/ët kontabël i miratuar do të caktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nëse është e nevojshme.

**Neni 15**  
**Viti financiar**

15.1 Viti financiar i Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit.

15.2 Përrjashtimisht, viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën 31 Dhjetor 2021.

**Neni 16**  
**Bilanci i Shoqërisë. Kontabiliteti**

16.1 Bilanci i Shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe do të përgatitet për dorëzim tek organet tatimore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

16.2 Librat kontabël do të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (LEK). Shoqëria mund të mbajë llogari të tjera në monedhë të huaj, shuma këto të cilat do të konvertohen në monedhën vendase çdo muaj.

16.3 Shoqëria mund të marrë financim prej instituteve financiare që operojnë në Shqipëri apo jashtë saj. Për këtë arsye Shoqëria mund të vendosë pjesë të kapitalit si garanci, ose mund të bjerë dakord të hipotekojë pasuri të saj të paluajtshme me vendim të Asamblesë së Përgjithshme .

**Neni 17**  
**Likuidimi**

17.1 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë prishjen e Shoqërisë.

17.2 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme do të caktohet një likuidator ose disa likuidatorë të cilat do të ndjekin procedurat e likuidimit.

17.3 Likuidatori(ët) do të përgatisin një raport likuidimi i cili do të përmbajë një pasqyrë të gjendjes ekonomike të shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e kërkuar për mbylljen e saj. Në





përfundim të procesit, Asambleja e Përgjithshme do të analizojë bilancin përmbyllës dhe do të miratojnë përfundimin e procesit të likuidimit.


**Neni 18**  
**Ndryshime të Statutit**


- 18.1 Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me dispozitat e legjislacionit tregtar.

**Neni 19**  
**Dispozitat Përfundimtare**

- 19.1 Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (Katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

**ORTAKËT**

**Muhamet Zeneli**  
*Muhamet Zeneli*  
  
\_\_\_\_\_  
(emër, mbiemër, nënshkrimi)

**Flavio Zeneli**  
*Flavio Zeneli*  
  
\_\_\_\_\_  
(emër, mbiemër, nënshkrimi)